

Shoqata Kulturore Kërçova – Zvicër në Kuvendin e përgjithshëm të mbajtur më dt. 10.06.2012 në Aarburg të Zvicrës, vendosi që të pranojë këtë Statut të ndryshuar dhe të plotësuar nga Statuti i mëparshëm i dt.20.04.2008.

Statuti i Shoqatës Kulturore Kërçova – Zvicër

I. Dispozitat e përgjithshme

1. Shoqata Kulturore Kërçova në Zvicër është organizim i krijuar me vetë vullnetin e lirë të bashkatdhetarëve nga Kërçova që jetojnë në Konfederatën Zvicerane; është Shoqatë joqeveritare dhe jopartiake me karakter social, humanitar dhe kulturor, që mbështetet në parimet Demokratike Kushtetuese, mbi ligjet e Konfederatës Zvicerane dhe Normat Ndërkombëtare të së Drejtës.
2. Emri i Shoqatës është „Shoqata Kulturore Kërçova – Zvicër” (SHKKZ – është shkurtesë e emrit të plotë të Shoqatës).
3. Shoqata ka statutin, logon dhe vulën e vet (nuk përjashtohet mundësia të ketë edhe flamurin e vet).
4. Adresa : Anglikerstrasse 83, 5612 Villmergen.
5. Vula:
6. E drejta juridike e Shoqatës është bazuar dhe përputhur me ligjet e Shtetit Zviceran, duke respektuar të drejtat dhe obligimet që dalin nga Neni 60ff i ZGB

II. Misioni dhe Qëllimi

7. Misioni dhe Qëllimi

Shoqata ka për qëllim :

- 7.1 Të ruaj, të zhvillojë dhe të kultivojë kulturën dhe traditën Shqipëtare për Shqipëtarët në Zvicër në veçanti Kërçovarët.

- 7.2 Të japë ndihmesën për evidentimin e vlerave kulturore, artistike, sportive.... etj..
- 7.3 Të ndihmojë integrimin e anëtarëve të Shoqatës në shoqërinë zvicerane, përmes aktiviteteve kulturore, sportive, humanitare, arsimore etj., në përputhje me statutin e Shoqatës.
- 7.4 Ndërtimin dhe përparimin e lidhjeve miqësore ndërmjet kërçovarëve dhe qytetarëve zviceran pa marrë parasyshë përkatësinë e tyre nacionale apo fetare.
- 7.5 Të bashkëpunojë me organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe me institucionet shtetërore në Zvicër, në Maqedoni dhe në gjithë Botën me qëllim të promovimit të tolerancës ndëretnike, të bashkëpunimit dhe të realizimit të aktiviteteve humanitare, kulturore, sportive etj..
- 7.6 Përkujdesjen dhe afrimimin e gjuhës shqipe dhe vlerave kombëtare.
- 7.7 Të njohë dhe të vlerësojë opinionin publik të trevës kërçovare për problemet e ndryshme që u takojnë banorëve kërçovarë që jetojnë në Zvicër e që paraqesin interes të përbashkët t'i publikojnë ato. (Media, Shtyp, Internet etj.).
- 7.8 Të bashkëpunojë dhe të krijojë marrëdhënie partneriteti e lidhjeje reciproke me Shoqata që kanë qëllime dhe objektiva të ngjajshme.
- 7.9 Të ndikojë në rritjen e shkallës së solidaritetit në mes të anëtarëve dhe familjes kërçovare në Zvicër.
- 7.10 Shoqata nuk është organizatë politike, por në rast se çënohen të drejtat legjitime të kombit shqiptar ka të drejtë të ngre zërin dhe të përkrahë kauzën e përgjithshme kombëtare me mjete të lejueshme legjitime dhe demokratike.
- 7.11 Të përkrahi aktivitetet me karakter shkencor, edukativo-arsimor dhe informativ (psh. Tribunat letrare, kulturore, simpoziumet shkencore, Stimulimi i studentëve etj.).

III. Struktura Organizative

- Organet e Shoqatës:
 - Kuvendi i Përgjithëshëm
 - Kryesia
 - Komisioni Mbikqyrës apo Kontrollues

8. Kuvendi i Përgjithshëm

- 8.1 Kuvendi i Përgjithshëm është organi më i lartë i Shoqatës.
- 8.2 Kuvendi përfshin nga 2 ose 3 përfaqësues (anëtarë) të bashkësive lokale të Kërçovës dhe 3 ose 5 përfaqësues të qytetit të Kërçovës.
- 8.3 Në Kuvend kanë të drejtë të marrin pjesë edhe sponsorët.
- 8.4 Kuvendi i Shoqatës mbledhet të paktën 2 herë në vit, me kërkesën e Kryesisë së Shoqatës.
- 8.5 Kuvendi miraton rregulloren e brendshme dhe programin periodik të Shoqatës.
- 8.6 Vendimet në Kuvend merren me shumicën e votave të anëtarëve (kuvendarëve) që janë të pranishëm në mbledhje.
- 8.7 Për ndryshimin e Statutit për përjashtimin e një Anëtari dhe për shpërndarjen e Shoqatës duhet të jenë të paktën $\frac{3}{4}$ e Kuvendarëve.
- 8.8 Mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret edhe nga $\frac{1}{5}$ e anëtarëve të Shoqatës sipas Kodit Civil të ZGB.

9. Kryesia e Shoqatës

- 9.1 Kryesia e Shoqatës zgjidhet çdo 4 vjet me votim të fshehtë nga Kuvendi i Shoqatës.
- 9.2 Kryesia përbëhet nga : kryetari, nënkryetari, sekretari, arkëtari dhe së paku 9 anëtarë të tjerë.
- 9.3 Në stafin egzekutiv Kryesia ka Komisionet e veta :
 - Komisionin Arsimor
 - Komisioni Sportiv
 - Komisioni Artistik
 - Komisioni Mediatik
 - Komisioni i Sponzorimit
 - Komisioni i Forumit Rinor
- 9.4 Kryesia harton rregulloren e brendshme të funksionimit të Shoqatës dhe projekt-programin e saj periodik.
- 9.5 Kryesia ka të drejtë të marrë aktivitete konkrete dhe fonde përkatëse për realizimin e tyre duke ia drejtuar (dërguar) Kuvendit në mbledhjen e rradhës.

9.6 Në funksion të Shoqatës, me aprovim të Kryesisë mund të bëhen aplikime për projekte të ndryshme.

9.7 Kryesia e Shoqatës mund të punësojë njerëz të aftë si ndihmë profesionale për projekte konkrete psh. juristë, kontabilistë, studentë ...etj., ndërsa kushtet rreth punësimit do të caktohen nga Kryesia dhe pala pranuese e detyrës.

Anëtarët e Kryesisë punojnë në mënyrë vullnetare dhe kanë të drejtë në zhdëmtim, parimisht vetëm në rast të harxhimeve efektive dhe shpenzimeve në të holla.

9.8 Antarëve të Kryesisë u bëhet në vlerë simbolike kompensimi në të holla për shpenzimet rrugore dhe projekte të veçanta, që shumën e caktonë Kryesia e Shoqatës.

10. Komisioni Mbikqyrës apo Kontrollues

10.1 Ky komision është përgjegjës për shqyrtimin dhe mbikqyrjen e dokumenteve finansiare të Shoqatës, i përbërë prej Kryesuesit dhe dy bashkanëtarëve, të zgjedhur nga Kuvendi.

10.2 Ky Komision zgjidhet nga Kuvendi i përgjithshëm, me mandat 4 vjecarë, dhe duhet të raportojë bilansin vjetor para Kuvendit të përgjithshëm .

IV. Anëtarësia

11. Në Shoqatë ka të drejtë të anëtarësohet çdo person që është me origjinë nga Kërçova dhe që pranon programin dhe statutin e Shoqatës.

12. Çdo anëtarë i Shoqatës është i obliguar që të paguaj anëtarësinë vjetore në mënyrë të rregullt, kurse pagesa bëhet në fillim të çdo viti kalendarik.

13. Asnjë anëtar nuk ka të drejtë të deklarojë publikisht asgjë në emër të Shoqatës, pa lejen paraprake të Kryesisë.

14. Çdo anëtarë i pranishëm në mbledhje ka të drejtë vote, të zgjedhë dhe të zgjidhet.

15. E drejta për të dhënë dorëheqje i garantohet çdo anëtari të Shoqatës pa asnjë kusht.

16. E drejta e anëtarësisë në Shoqatë nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me anë trashigimie.

17. Anëtarët që kanë dhënë dorëheqje, ose janë përjashtuar nga Shoqata, nuk kanë të drejtë në kapitalin apo pasurinë themelore të Shoqatës.
18. Çdo anëtarë ka të drejtën e vet, të shfaqë mendimin e tij, të diskutojë në mbledhje, të kërkojë përgjegjësi dhe llogari prej Kryesisë dhe Kuvendit të Shoqatës.
19. Kryesia mund t'i propozojë Kuvendit të përgjithshëm largimin e një anëtari, nëse këtë e sheh të arsyeshme. Kryesia nuk është e obliguar t'i arsyetohet anëtarit të larguar.
20. Shoqata ka të drejtë të ketë anëtarë nderi dhe kohëzgjatja është e pacaktuar, në përjashtim të shkeljes së Statutit.

V. Të hyrat dhe të dalat e Shoqatës

21. Të hyrat e Shoqatës përbëhen nga :

- 21.1 Anëtarësia
- 21.2 Sponzorët
- 21.3 Fitimet nga aktivitetet e ndryshme
- 21.4 Manifestimet kulturore dhe turniret
- 21.5 Pagesat vullnetare dhe dhuratat

22. Daljet e Shoqatës përbëhen nga:

- 22.1 Kostot administrative
- 22.2 Pagesa e zyrës (qiraja)
- 22.3 Marketingu (Reklama)
- 22.4 Të dalat e Shoqatës që përcaktohen nga Kuvendi i përgjithshëm dhe Kryesia.
- 22.5 Të dalat që përcaktohen nga Statuti që përmbushin qëllimet dhe detyrat e Shoqatës.

VI. Sponzorët

23. Sponzorë në Shoqatë mund të jenë të gjithë ata persona dhe persona juridik që e pranojnë rregulloren e Statutit të Shoqatës për Sponzorizim.
24. Shoqata posedon rregullore të posaçme për Sponzorim (rregullat e sponzorimit caktohen nga Kryesia)

VII. Dispozita përfundimtare

- 25.** Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqatës është e pakufizuar.
- 26.** Shkapërderdhja, bashkimi dhe përshtatja e synimit të Shoqatës mund të bëhet vetëm në Kuvendin e përgjithshëm, me shumicën absolute të pranishmive me të drejtë vote.
- 27.** Ndryshimet dhe plotësimet në Statut miratohen me Kuvend të përgjithshëm me shumicën absolute të pranishmëve me të drejtë vote.
- 28.** Në rast të shpërbërjes së Shoqatës, të mirat e Shoqatës dhe inventari (do të shitet sipas nevojës) do të shlyhen të gjitha pagesat, e pjesa e mbetur do t'i jepet ndonjë Organizate Kërçovare që ka qëllime të njejta, ndonjë Fondi humanitar Kërçovarë, bursa studentore Kërçovarë etj., për ç'gjë vendos Kryesia e Shoqatës.
- 29.** Ky Statut hyn në fuqi ditën e sjelljes, ndërsa do të fillojë të zbatohet ditën e regjistrimit në Regjistrin e Organizatave Joqeveritare.
- 30.** Shoqata Kulturore Kërçova – Zvicër në Kuvendin e përgjithshëm, të mbajtur më 10.06.2012 në Aarburg të Zvicrës, vendosi që të pranojë këtë Statut të ndryshuar dhe të plotsuar nga Statuti i 20.04.2008.

➤ Nënshkruesit e Statutit të Shoqatës Kulturore Kërçova – Zvicër:

Kryetari:

NënKryetari:

Begzat Limani

Florim Useini

Sekretari:

Arkatari:

Resul Mehmedi

Sadin Emini